



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES

Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 22 23 10 e-mail: info@Durrës.gov.al

Nr 8206 Prot

Durrës më, 10/12 /2014

KONTRATË PËR PUNË PUBLIKE

“Rikonstruksion rruge “Polumbari”

Nr. References se Kontrates: BD.PH.50.14

Lidhur ndërmjet palëve

Bashkise Durrës “*Autoriteti Kontraktor*”

Dhe

ÇAUSHI+VARAKU E “*Kontraktuesi*”

KONTRATË
Rikonstrukcion rruge "Polumbari"
Nr i referencës BD.PH.50.14

Kjo marrëveshje (Kontratë) nënshkruhet sot më datë 10 . 12 . 2014 Durrës ndërmjet dy palëve :

"Autoriteti Kontraktor" **Bashkia Durrës**
Adresa : Sheshi "Iliria", Qyteti Durrës
Tel /fax: 052 22 23 10
NIPT : K42006501R
Përfaqësuar nga Kryetari Bashkise z. Vangjush **DAKO**

Dhe

"Kontraktuesi" **ÇAUSHI+ VARAKU E**
Adresa : Durres, L.Perimore Sukth
Tel /Fax: 0692054950
NIPT : J81603502G & J61902509S
Përfaqësuar nga Administratoret z. Xhevahir **ÇAUSHI** dhe z. Shpetim **VARAKU**

Neni 1 - Baza ligjore

Kontrata mbështetet në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 " Për prokurimin publik", KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit, ligji nr. 8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2- Përbërja e kontratës

2.1 Kontrata do të përbëhet nga dokumentet e mëposhtëme dhe dokumentat të tjera të tenderit te dates 03.11.2014 duke përfshirë KPK dhe KVK ne dokumentat e tenderit

1. Formulari i Kontratës i nënshkruar nga palët me dokumentat e tenderit të cilësuar në të.

2. Sigurimi i kontratës në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e garancisë lëshuar nga shoqëri sigurimi .

3. Oferta teknike dhe ekonomike paraqitur nga kontraktuesi në tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor , me specifikimet teknike, projekti, preventivin me çmimet për njësi dhe vlerën sipas Aneks-kontratës.

2.2 Prokure e posacme, Kontrat Bashkepunimi:

Bashkangjitur Prokure e posacme, Kontrat Bashkepunimi, grafik punimesh.

2.3 Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës ne dokumentat e tenderit.

Neni 3 – Objekti i kontratës

3.1 Janë të gjitha Punet për “Rikonstruksion rruge “Polumbari” (sipas skicave, projektit) të cilat kontraktori do ti siguroje sipas kushteve të kontratës.

3.2 Kantieri i ndërtimit do të jetë ne objektet e percaktuara nga Kontraktori.

Neni 4 – Çmimi i kontratës

4.1 Çmimi që i paguhet kontraktuesit për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të kontratës është 4'390'300 (kater milion e treqind e nentedhete mije e treqind) leke pa Tvsh dhe me vleftë me Tvsh 5'268'360 (pese milion e dyqind e gjashtedhjet e tete mije e treqind e gjashtedhjet) lekë:

4.2 Kontrata është Kontrate me Çmim Njesie te bazuar ne çmimet e njesise te shprehura ne Preventivin per Njesi.

Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në Njësi për secilin zë punimesh.

Neni 5 –Mënyra dhe afatet e Pagesës

5.1 Pagesa do te behet me transferte bankare brenda 30 diteve kalendarike nga realizimi i punimeve (data e vertetuar nga Autoriteti Kontraktor se punet jane mbaruar).

5.2 Pagesa do te behet sipas situacionit/situacioneve mujore te puneve te verifikuara dhe te konfirmuara nga Drejtuesi i Projektit duke dorezuar situacion dhe faturen tatimore.

5.3 Te gjitha te drejtat dhe detyrimet me Bashkine Durres do te kryhen nga ÇAUSHI, sipas prokures (bashkangjitur)

5.3 Monedha e pagesës do të jetë monedha shqiptare (lekë) .

5.4 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 6 - Grafiku i realizimit të punimeve

6.1 Grafiku i realizimit te punimeve i paraqitur nga kontraktuesi dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, kerkohet te siguroje realizimin e te gjitha puneve brenda **60 diteve** (afati prej 60 diteve, zbatohet sipas ligjit nr. 8402 date 10.09.1998 dhe udhëzimeve te nxjerra ne zbatim te këtij ligji me ndryshimet përkatëse).

Neni 7 – Sigurimi teknik

7.1 Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjithë aktiviteteteve në kantier.

Neni 8 – Detyrat e kontraktorit.

8.1 Kontraktori do të kryejë dhe mbarojë punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit dhe të pranuar sipas Anex-kontrates bashkangjitur.

8.2 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollimin e cilësisë së punimeve dhe cilësisë së materialeve gjatë zbatimit të kontratës . Ai duhet të njoftojë Drejtuesin e Projektit dhe Autoritetin Kontraktor për rrethana specifike që mund të ndikojnë negativisht në punë për realizimin e objektit të kontratës.

8.3 Sa herë që të jepet njoftimi për difekte, kontraktori duhet ti korrigjojë ato brenda kohëzgjatjes së parashikuar në njoftim .

8.4 Kontraktori duhet ti paraqese drejtuesit te projektit nje program plan dhe te pergatise sipas aprovimeve te tij raportimet per ecurine e punimeve, kontrollin e cilesise dhe situacionet per punimet e kryera.

8.5 Kontraktori duhet te zbatoje : **kushtet teknike te zbatimit ne fuqi**

Neni 9- Drejtuesi i Projektit

9.1 Drejtuesi i Projektit është personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor, qe eshte përgjegjës për administrimin e kontratës per Autoritetin Kontraktor.

9.2 Drejtuesi i projektit ne se zbulon se punimet nuk jane perfunduar plotesisht do ti jape udhезime me shkrim kontraktorit qe specifikojne zerat e punimeve ose aktivitetet qe duhen perfunduar .

9.3 Drejtuesi i projektit duhet te kontrolloje punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet te vertetoj per Autoritetin Kontraktor shumen qe duhet ti paguhet kontraktorit në bazë të Situacionit / situacioneve të marra nga kontraktuesi .

Neni 10 – Korrigjimi i difekteve

10.1 Nëse Kontraktori nuk ka korrigjuar një difekt brenda kohës së specifikuar në njoftim, Drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të difektit dhe kjo shumë do të mbahet nga pagesa që duhet bërë kontraktuesit derisa difekti të korrigjohet .

Dështimi për të korrigjuar difektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate per arsye mospermbushje ne favor te Autoritetit Kontraktor.

Neni 11- Mbarimi dhe marrja persiper e puneve.

11.1 Kontraktori pas perfundimit te puneve i paraqet drejtuesit te projektit dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare te punimeve te kryera dhe i kerkon atij te leshoje nje çertifikate per mbarimin e punimeve dhe drejtuesi i projektit do ta beje kete sapo te vendosi se punimet jane mbaruar plotesisht.

11.2 Drejtuesi i projektit në rast se gjatë kolaudimit zbulon Pune te pa perfunduara plotesisht ose defekte ne Punime të cilat janë pasojë e punës jo cilësore të Kontraktuesit, do ti paraqesi atij me shkrim dhe do kërkojë kryerjen dhe riparimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 12 – Rreziqet e Kontraktuesit

12.1 Nga data e hyrjes në kantier deri në përfundim të punimeve Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për dëmtim personal , vdekje, humbje ose dëmtim të pasurisë .

Neni 13- Siguracioni

13.1 Minimumi i kërkuar për tu mbuluar nga sigurimet sipas ligjeve në fuqi janë:

- a. Sigurimi për demttime ose humbje te puneve dhe materialeve
- b. Per demttime ose humbje te pajisjeve
- c. Per demttime ose humbje te pasurise pervec puneve, Materialeve dhe Pajisjeve
- d. Per demtim personal ose vdekje te personave ne kantier.

Neni 14 – Likuidimi i demeve

14.1 Tarifa ditore për demet e likujdueshme per vonesën në mbarimin e Punimeve përtej afatit 60 ditor do të jetë 4/1000 e vleres koresponduese te mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontrates por jo me pak se 25 perqind e vleres se saj.

14.2 Kamata e shperblimit per demet e shkaktuara si rezultat i voneses ne berjen e pageses perllogaritet nga data e fillimit te voneses qe eshte 30 dite nga data e vertetuar per Autoriteti Kontraktor se punet jane mbaruar.

Neni 15 – Forca madhore

15.1 Kontraktuesi do të çlirohet nga përgjegjësia për moszbatimin e detyrimeve kontraktuale që vijnë si rezultat i forcës madhore.

15.2 Nëse ndodh një situatë e tillë kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Autoritetin Kontraktor . Sipas rastit të veprimit të këtij fenomeni palët me marrëveshje e mirëkuptim përcaktojnë kushtet dhe afatet e reja praktikisht te arsyeshme per zbatimin e detyrimeve te kontrates.

Neni 16 – Zgjidhja e kontratës

16.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse :

- a) Kontraktori dështon në kryerjen e puneve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes se dhene; ose,
- b) Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj kontrate.

16.2 Autoriteti kontraktor do ti japë kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe ti japë kontraktorit 15 ditë që të ndreqë mosplotësimin .

16.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punet e perfunduara brenda Autoritetit Kontraktor do te behen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata nderpritet për mosplotësim te kushteve te saj.

Neni 17 – Sigurimi i kontratës

17.1 Shuma e sigurimit të kontratës prej 10 % të vlerës së kontratës do ti paguhet Autoritetit Kontraktor si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

17.2 Sigurimi i kontratës do ti kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorezim të punimeve.

17.3 Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës, që do ti mbahet Sipërmarrësit mbi vlerën totale nga situacioni perfundimtar si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të këtij afati.

Garancia për mbulimin të difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e Kontraktuesit është 2 vjet.

Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

18.1 Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura në lidhje me këtë kontratë me mirëkuptim dhe negociata midis tyre.

18.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do ti drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës dhe problemet do të zgjidhen sipas procedurave juridike në fuqi dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë .

Neni 19- Dispozita të fundit

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dy palëve në shtate kopje, 1 (një) për Kontraktuesin dhe 6 (gjashte) për Autoritetin Kontraktor.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi

Bashkia Durrës

ÇAUSHI+ VARAKU E

Emri dhe firma e Përfaqësuesit
Vangjush DAKO
Kryetar i Bashkisë

Emri dhe firma e Përfaqësuesve

Vula:



Xhevahir ÇAUSHI

"ÇAUSHI" SH.P.K
NUMERIM I EXPORT-IMPORT
SH.P.T. TEL: 03.502G
DURRËS - ALBANIA

Shpetim VARAKU

Administrator te shoqërive
Vulat:



ANEKS- KONTRATE
“Rikonstruksion rruge “Polumbari”
Nr. References se Kontrates: BD.PH.50.14

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: **Bashkangjitur**

Specifikimet Teknike te Materialeve: **Bashkangjitur**

GRAFIKU I REALIZIMIT

Afati i perfundimit te punimeve eshte 60 dite kalendarike (afati prej 60 diteve, zbatohet sipas ligjit nr. 8402 date 10.09.1998 dhe udhëzimeve te nxjerra ne zbatim te këtij ligji me ndryshimet përkatëse).

GARANCIA

Garancia per mbulimin te difekteve, qe mund te lindin gjate shfrytezimit te objektit, nga ana e kontraktuesit eshte 2 vjet.

PREVENTIV PUNIMESH

Me objekt: Rikonstruksion rruge “Polumbari

Nr	Nr. AN	ZERAT E PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
I		Punime ne rruge				
3	3/209	Shtrese cakull minash t=1x 10cm perhapur e ngjeshur me makineri	m ²	1600	90	144,000
4	3.208	Shtrese çakulli makinerie t=10cm, perhaper e ngjeshur me makineri	m ²	1600	90	144,000
5	3.212/b	Shtrese stabilizanti t=10 cm , perhaper e ngjeshur me makineri	m ²	1650	140	231,000
6	2.238	Kunete anesore betoni M=150t=12 cm	m ³	35	6500	227,500
7	3.229/2	Shtrese binderi t=6cm me granil guri + prajmer + rrulim	m ²	1650	700	1,155,000
8	3.233/1	Shtrese asfalti t=4cm me granil guri +prajmer + rulim	m ²	1650	650	1,072,500
9	3.238	Beton M=150 nen bordure t=10 cm	m ³	18	5300	95,400
10	3.617	F.V. Bordure 15*15*25	ml	630	650	409,500
		Shuma II				3,478,900

II Punime per KUB						
1	3.88/b 2.158/5a	Germim dheu kanal per kub e kub me makineri + transport	m ³	160	280	44,800
3	3An	F.V. tub Ø 250 PE SN4 per kub	ml	330	800	264,000
5	2.258/2	Mbushje kanali kub e kuz me rere dhe cakull nen dhe mbi tub	m ³	42	600	25,200
6	2An22/16	Puseta shimbledhese + zgare metalike 40x70	cope	11	8500	93,500
Shuma III						427,500
II Punime ne trotuare						
1	3.209	Shtrese cakull minash kave t=10cm + rulim	m ²	96	900	86,400
2	3.238	Shtrese betoni M=150 t=8cm	m ³	75	5300	397,500
Shuma IV						483,900
Shuma I -III						4,390,300
TVSH 20%						878,060
TOTALI						5,268,360

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi

Bashkia Durres

ÇAUSHI+ VARAKU E

Emri dhe firma e Përfaqësuesit
Vangjush DAKO
Kryetar i Bashkise

Emri dhe firma e Përfaqësuesve

Vula:



Xhevahir ÇAUSHI
Xhevahir Çaushti

Shpetim VARAKU
Shpetim Varaku

Administrator te shoqërive
Vulat:

